

# Mbledhja e kryesisë së shoqatës 17shkurti.ch

PROTOKOLL

DATA: 05.11.2017

KOHA: 11:00

VENDI: GLATTBRUGG

THIRRUR NGA:	Kryetari Muhamet Guda
NUMRI I MBLEDHJËS	9
UDHËHEQËS I MBLEDHJËS	Muhamet Guda
PROTOKOLLIN E SHKRUAN	Visar Kryeziu
PJESËMARRËS	Faik Mahmuti, Avni Kastrati, Muhamet Guda, Agron Zahiri, Visar Kryeziu
MUNGOJNË	Askush

## TEMAT E DITËS

<ol style="list-style-type: none"><li>1. Diskutimi per funksionimin e shoqates</li><li>2. Permbyllja e aksionit te shtepise</li><li>3. Te ndryshme</li></ol>
--

DISKUTIMI	Tema Nr. 1 Diskutimi per funksionimin e shoqates	
	<p>U diskutua per ne pergjithesi per kryesine dhe prblemet qe po ballafaqohet ne zgjidhjen e problemeve qe paraqiten gjate realizimit te projekteve. Natyrisht se aty ku punohet do te shfaqen edhe problemet gjate realizimit te projekteve. Verejtje kishte mjaft nga gjithe kryesia duke filluar nga vendosja e bankave edhe pse kryesia kishte votuar qe bankat te vendoseshin pas zgjedhjeve, ato u vendosen ne kohen sa ishte ende fushata parazgjedhore e partive politike si dhe mundesia qe keto pune te shoqates te keqperdoren ne fushatat te tyre. Menagjimi i mjeteve te shoqates qe i takojne vetem shoqates se ku po mbesin, si psh kantat per mbeturina qe nuk ishin ne shfrytezim per nje kohe. Vrejtja ishte qe te mos guxojn te perdoren ato nga persona privat. Perdorimi i chat-it ne mes te kryesise i cili po sjell probleme ku problemet po diskutohen permes shkrimeve i cili nuk po arrijn te zgjidhen permes saj. U diskutua edhe per bashkepunimin me punetoret e shoqates si dhe raportet mes vete, per problemet e pageses se rrogen ndaj tyre, pergjegjesite e secilit nga ne dhe mosperzierja e kompetencave te secilit nga ne.</p>	
VENDIMI		
	U vendos qe deri ne fund te ketij mandati te kryesise pergjegjes per punetoret te jete Muhamet Guda.	
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI
Muhamet Guda te jete personi i vetem pergjegjes nga kryesia per punetoret.	Muhamet guda	Tani

<b>DISKUTIMI</b>	<b>Tema Nr. 2</b> Permbyllja e aksionit te shtepise	
<p>U diskutua per aksionin e shtepise si dhe problemet qe po hasen per tubimin e te hollave per kete shtepi. Behet fjale per blerjen e shtepise per familjen e Nexhat Selmanit ne Doberçan. Aksioni eshte hapeur nje vit me heret, eshte mbyllur dhe serish hapur kete vit, mirepo nuk ka sukses ne tubimin e mjaftueshem te te hollave.</p> <p>U vendos qe ti dergohen sms te gjithë anetareve te shoqates qe jetojne kryesisht ne Zvicer, dhe te njoftohen qe aksioni eshte i hapur deri me 30 Nentor 2017 dhe pas kesaj date ky aksion te perfundoj automatikisht si dhe te hollat e mbledhura ti ipen organizatorit te ketij aksioni ne Doberçan Behlul Behlulit.</p>		
<b>VENDIMI</b>		
Ti dergohen sms anetareve te shoqates per aksionin e shtepise qe mbetet i hapur deri me 30 Nentor 2017.		
<b>DETYRAT</b>	<b>PERSONI PËRGJEGJËS</b>	<b>TERMINI</b>
Visar Kryeziu ti dergoj sms te gjithë anetareve te shoqates per aksionin.	Visar Kryeziu	Pas mbledhjes

<b>DISKUTIMI</b>	<b>Tema Nr. 3</b> Te ndryshme	
<p>Agron Zahiri kerkon nga kryesia qe te gjendet nga tash nje arkatar qe eshte i gatshem te marr detyren e arkatarit dhe qe Agroni ta mesoj punen e arkatarit ne menyre qe ne te ardhmen mos te kete problem.</p> <p>U diskutua gjithashtu per nje ankese qe kishte ardhur per nje ulese qe eshte vendosur dhe mundesise qe kjo ulese te vendoset ne anen e kundert, dmth me pamje nga lumi. U vendos qe per kete ulese te diskutohet me ate lagje dhe nese lagjja eshte e pajtimit qe te ndrrohet vendosja e saj, ateher te vendoset ashtu ata si deshirojn.</p>		
<b>VENDIMI</b>		
/		
<b>DETYRAT</b>	<b>PERSONI PËRGJEGJËS</b>	<b>TERMINI</b>
/	/	/